



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Tiranë, 24 prill 2021. Në vijim të masave administrative dhe procedurale të ndërmara nga Prokurori i Përgjithshëm për të garantuar funksionimin normal të prokurorisë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore për periudhën para dhe pas zgjedhore, prokuroria është angazhuar për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm.

Deri në datën 23 prill 2021 prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë raportuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, mbi veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, si më poshtë:

- Për veprën penale, Neni 238 “Kanosje për shkak të detyrës” - **1** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht
- Për veprën penale, Neni 248 “Shpërdorim detyre” - **10** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht
- Për veprën penale Neni 325 “Pengimi i subjekteve zgjedhore” - **11** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht kryesisht si dhe **1** material kallëzues ardhur me transferim
- Për veprën penale, Neni 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” - **26** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht si dhe **1** material kallëzues ardhur me transferim
- Për veprën penale, Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik” - **11** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht si dhe **7** materiale kallëzuese të ardhura me transferim
- Për veprën penale, Neni 329 “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” - **1** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht
- Për veprën penale, Neni 330 “Pengimi i zgjedhësit” - **3** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht
- Për veprën penale, Neni 331/a “Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit” - **1** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht

Nga referimet në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për veprat e sipërcituara rezultoi se:

- janë transferuar pa u regjistruar procedimi - 20
- janë në proces verifikimi paraprak - 21
- mosfilluar – 1
- ardhur me transferim si procedim nga një prokurori tjetër – 1
- çështje penale të transferuara – 2
- procedime në hetim – 28